



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, 24 dhe 40 të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 27, 28 dhe 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miraton këtë:

### **Projekt-V E N D I M**

#### **Neni 1**

- 1.1 Me këtë vendim miratohet kërkesa 03-Nr-181-54736 e datës 16.09.2024 e parashtruar nga Shefket Kololli nga fshati Budakovë Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar, pasi që me datën 27.08.2024 i është djegur shtëpia.
- 1.2 Me këtë vendim miratohet kërkesa 03-Nr-820-55418 e datës 19.09.2024 e parashtruar nga Hajrush Destani nga fshati Delloc Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar pasi që me datën 15.09.2024 i është djegur shtëpia.
- 1.3 Me këtë vendim miratohet kërkesa 03-Nr-553-64198 e datës 18.11.2024 e parashtruar nga Nezir Loshi nga fshati Vraniq Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar pasi që me datën 10.11.2024 i është djegur shtëpia.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare lëshohen nga Agjencioni për menaxhimin e emergjencave në Prishtinë pas vlerësimit të dëmit nga komisioni i formuar nga AME-ja.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Agjencioni për menaxhimin e emergjencave në Prishtinë në bashkëpunim me Drejtorin për shërbime publike dhe emergjencë të Komunës së Suharekës.

#### **Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## **K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Me datë\_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**